



Made for minds.

Kodi i sjelljes

Vlerat tona. Qëndrimi ynë. Veprimet tona.

Të jetojmë vlerat tona





Të nderuar kolege dhe kolegë,

DW (Deutsche Welle) arrin në mbarë botën më shumë njerëz se asnjëherë më parë, duke gëzuar një besueshmëri dhe vlerësim gjithnjë e më të lartë si një zë i pavarur. Ne duam të informojmë njerëzit, veçanërisht aty ku iu nënshtrohen censurës dhe propagandës dhe ku mungon diversiteti dhe perspektiva. Aty ne prezantojmë edhe pozicione kontroverse.

Ne nxisim qasjen në informacionin e lirë dhe lirinë e shprehjes në mbarë botën.

Të gjithë ne në DW na bashkon i njëjti vizion, i cili për ne është: liria, demokracia, të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit, toleranca dhe transparenca ndaj publikut. Për këtë arsye ne refuzojmë çdo formë diskriminimi si seksizmi, racizmi, antisemitizmi e të tjera. Po ashtu për shkak të përgjegjësisë historike të Gjermanisë për Holokaustin ne mbështesim të drejtën e ekzistencës së Izraelit. Për këto vlera jemi garantë. Kjo reflektohet jo vetëm në përmbajtjen gazetareske që ofrojmë dhe projektet e politikës së zhvillimit dhe programet arsimore të DW Akademie, por edhe në ndërveprimet e përditsh-

me të një stafi nga më shumë se 160 kombe në diversitetin e tyre të plotë.

Si një institucion mediatik me aktivitet në mbarë globin dhe me një mandat publik, ne kemi përgjegjësi të veçantë ndaj përdoruesve, partnerëve të projekteve, të distribucionit dhe biznesit, shoqërisë dhe mjedisit. Ky «Kodi i sjelljes» përshkruan mënyrën se si i perceptojmë ne këtë përgjegjësi brenda dhe jashtë kompanisë.

Ne praktikojmë vlerat dhe parimet, normat dhe standardet që përçojmë dhe nxisim në mbarë botën si në vetë DW, ashtu edhe në bashkëpunimin me partnerët tanë. Kjo shprehet në «Kodin tonë të sjelljes».

Si «Kodi i sjelljes» ai përmbledh parimet e detyrueshme dhe standardet e sjelljes, që drejtojnë veprimet tona të përditshme dhe marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Respektimi i ligjit dhe rregullit është thelbësor për ne në çdo gjë që bëjmë. «Kodi i sjelljes» shërben kështu për garantimin e një sjelljeje në përputhje me ligjin dhe të një praktike pune me etikë të përsosur të të gjithë punonjësve të DW.

Parimet e mëtejshme bazë janë **Vlerat e Drejtimit të DW**, të cilat tani zbatohen në të gjithë kompaninë. «Kodi i sjelljes» është thelbësor për ruajtjen e reputacionit dhe suksesit tonë, si këtu në Gjermani, ashtu edhe në mbarë botën. Qëllimi i tij është të sensibilizojë të gjithë ata që punojnë për të përmbushur misionin tonë të DW për rëndësinë e këtyre parimeve dhe rregulloreve të brendshme ekzistuese, si dhe rëndësinë e respektimit të tyre. «Kodi i sjelljes» është i detyrueshëm për të gjithë punonjësit e DW-së dhe të degëve të saj.

Të gjithë ne si punonjës të DW-së jemi të detyruar që t'i përmbahemi «Kodit të sjelljes» dhe rregullave të sjelljes që ai përmban. Kjo vlen në veçanti për bordin ekzekutiv dhe stafin drejtues të institucionit, të cilët, në një masë të madhe, i japin formë kulturës së institucionit tonë. Stafi drejtues duhet të shërbejë si shembull.

Ai duhet të sigurojë që punonjësit të njohin dhe të kuptojnë «Kodin e sjelljes». Po ashtu ai ka përgjegjësinë për të ndërmarrë veprime kundër çdo sjelljeje, e cila nuk është në përputhje me ligjet në fuqi apo me udhëzimet e sjelljes dhe vlerat thelbësore të «Kodit të sjelljes».

Si një transmetues që mbron lirinë e fjalës dhe mendimit në mbarë botën, ne kemi krijuar gjithashtu brenda DW një klimë që lejon dhe duron kundërshtimet e argumentuara. Shkeljet e «Kodit të sjelljes» do t'i hetojmë dhe në rast nevojë do të marrim masa të nevojshme, veçanërisht në kuadrin e ligjit të punës.

Me respekt,
Peter Limbourg
Drejtor i Përgjithshëm

“ Ne të gjithë ndajmë një vizion të përbashkët.

Kodi i sjelljes

«Kodi i sjelljes» bazohet dhe u referohet të gjitha ligjeve, kontratave kolektive dhe rregulloreve të brendshme të DW -së, të cilat zbatohen në DW dhe veçanërisht atyre, që **përmban manuali** i DW. Është e vetëkuptueshme, që këto rregulla dhe udhëzime për sjelljen do të vazhdojnë të jenë të vlefshme nën ombrellën e «Kodit të sjelljes».

Nga ne si punonjës pritet të njihemi me këto rregulla në bazë të përgjegjësisë tonë. Për pyetje lidhur me rregulloret mund t'u drejtoheni stafit drejtues, së ngarkuarës për pajtueshmërinë si dhe departamenteve përkatëse.

Çfarë na dallon

E vetëkuptueshme për ne – informacione të hapura për vendimarrje të vullnetshme

Misioni ynë: si media e pavarur ndërkombëtare nga Gjermania ne informojmë njerëzit në të gjithë botën në mënyrë që ata t'i marrin lirisht vendimet e tyre.

Ne jemi *Made for minds*. Në dialog me ata që na ndjekin si dhe me partnerët tanë ne u ofrojmë mendjeve kritike në të gjithë botën perspektiva të reja mbi bazën e informacioneve të besueshme. Po ashtu ne u ofrojmë njerëzve mundësi për të mësuar. Ne u ndihmojmë njerëzve që të krijojnë në mënyrë të lirë dhe të pavarur mendimin e tyre, ta shprehin

atë lirisht dhe të krijojnë në këtë mënyrë së bashku shoqëri të hapura dhe demokratike.

Këto janë objektivat tona të deklaruara, por mënyra jonë e veprimit për arritjen e tyre është po aq e rëndësishme: ne kemi vlera të qarta që i ndajmë dhe pritshmëri të qarta për veten tonë dhe mënyrën se si ndërveprojmë me njëri-tjetrin. Ato janë një faktor i përbashkët i produkteve dhe shërbimeve tona dhe përcaktojnë vendimet dhe sjelljen tonë të përditshme.

Me përkushtim të qartë për lirinë

Liria, demokracia dhe të drejtat e njeriut janë gurët e themelit të mesazhit dhe profilit tonë të zhvillimit dhe gazetarisë. Ne mbrojmë vlerat e lirisë dhe, kudo ku ndodhemi, zëmë pozicione të pavarura dhe të qarta dhe veçanërisht kundër çdo lloj diskriminimi si seksizmi, racizmi dhe antisemitizmi. Ne mbajmë një përgjegjësi të veçantë për Izraelin për shkak të historisë gjermane.

Dialog i hapur, në rrjet global

Realiteti i jetës së njerëzve dhe nevojat e tyre janë në qendër të veprimeve tona si në gamën e shërbimeve tona gazetareske, ashtu dhe në ato të DW Akademie. Me një mendje të hapur, në një rrjet global dhe rajonal, ne jemi në dialog me njerëzit në mbarë botën. Gama e produkteve dhe shërbimeve tona ofron perspektiva të reja kudo dhe kurdo që ato nevojiten. Ne promovojmë shkëmbi min konstruktiv dhe i trajtojmë të gjithë me respekt, gjithmonë dhe kudo.

“ Ne përdorim diversitetin tonë për suksesin tonë reciprok.”

Njohuri të thella, perspektiva të shumëllojshme

Shumëllojshmëria dhe ekspertiza jonë janë kapitali ynë më i madh. Ne e shohim botën me kureshtje, hyjmë në shtigje të reja të guximshme, drejtojmë pyetje kritike dhe japim përgjigje të mbështetura me prova dhe të pavarura. Ekipet tona shumëgjuhëshe në më shumë se 60 vende në mbarë botën, së bashku me përdoruesit dhe partnerët tanë, krijojnë përmbajtje tërheqëse të përshtatshme dhe me cilësi të lartë. Ne promovojmë zhvillimin e sistemeve të medias së lirë, ofrojmë qasje në informacion dhe caktojmë standarde për arsimin dhe gazetarinë e pavarur. Ne ndajmë idetë tona dhe e përdorim diversitetin tonë për suksesin tonë të përbashkët.

Këto vlera bazë formojnë bazën e rregullave tona të sjelljes, duke siguruar bashkëpunim produktiv dhe respekt reciprok.

Respekti ynë për ligjin dhe rregulloret

Me udhëzimet e tij për sjelljen, «Kodi i sjelljes» rregullon ndërveprimet e përgjithshme brenda DW dhe ravigjeron sistemin e vlerave për punën tonë të përditshme, edhe në fushën e gazetarisë. Sigurisht, nën ombrelën e «Kodit të sjelljes» vazhdojnë të zbatohen ligjet në fuqi dhe rregulloret specifike të kompanisë.

Menaxhmenti dhe stafi drejtues japin shembullin e tyre dhe kanë detyrë të kontribuojnë që «Kodi i sjelljes» të respektohet.

DW pret që punonjësit e saj t'u kushtojnë vëmendje të veçantë pikave të mëposhtme. Shkeljet dënohen sipas ligjit të punës.

Ndalimi i diskriminimit sipas ligjit të trajtimit të barabartë (Allgemeines Gleichbehandlungsgesetz (AGG))

As në marrëdhëniet me njeri-tjetrin dhe as në ofertat tona ne nuk tolerojmë asnjë lloj diskriminimi sipas AGG, si seksizmi, racizmi dhe antisemitizmi. Ne nuk diskriminojmë as punonjës, as partnerë biznesi dhe as palë të tjera të treta, me të cilët kontaktojmë në kuadër të punës sonë për DW, as për motive antisemite apo raciste, apo për arsye të origjinës, gjinisë, fesë, apo botëkuptimit, aftësive të kufizuara, moshës, apo identitetit seksual. Ne

refuzojmë kategorikisht bullizmin dhe ngacmimin seksual. Të ndaluar janë edhe përhapja e pretendimeve të pavërteta ndaj personave të caktuar dhe fyerjet.

Ne tregojmë zero tolerancë ndaj nxitjes së urrejtjes etnike e racore apo sjelljeve të paligjshme, siç është mohimi apo relativizimi i Holokaustit.

Kufijtë e lirisë së shprehjes

Ne jemi të vetëdijshëm se liria jonë e shprehjes përfundon aty, ku kapërcehet kufiri drejt bullizmit, ngacmimit seksual dhe çdo sjelljeje tjetër që çënon nderin, si pretendimet e rreme apo shpifjet.

**“ Diskirmini
nuk tolerohet as
në marrëdhëniet
midis nesh dhe
as në atë që ne
ofrojmë.**

Ne jemi po ashtu të vetëdijshëm se deklaratat, që mohojnë apo relativizojnë holokaustin, nuk bëjnë pjesë në lirinë e shprehjes së mendimit.

Si punonjës të DW ne jemi të obliguar, që si brenda ashtu edhe jashtë punës sonë për DW, në deklaratat publike, edhe ne mediat sociale dhe publikime të tjera, të ruajmë maturinë në përmbytje dhe formë, gjë që rrjedh nga përgjegjësia jonë ndaj vlerave të DW dhe nga respekti ndaj kontratës së punës – dhe nga besnikëria ndaj DW si punëdhënëse si dhe ndaj punonjësve të tjerë. Duke pasur parasysh pozicionin dhe fushën e veprimtarisë sonë në DW, jemi të obliguar, që sjellja jonë jashtë punës në publik të mos prekë reputacionin dhe interesat legjitime të DW. Bërja e deklaratave diskriminuese, përfshirë ato seksiste, raciste dhe antisemite, nuk duhet lejuar në asnjë rast dhe mund të çojë në marrjen e masave në kuadër të ligjit të punës deri në pushimin nga puna.

Si punonjës ne njohim dhe respektojmë ligjet themelore, marrëveshjet kolektive, direktivat e brendshme të DW dhe në veçanti rregulloret e përcaktuara në manualin në «Manualin e DW» që u përkasin fushave tona të përgjegjësisë. Këto rregullore vazhdojnë të aplikohen dhe nuk zhvlerësohen nga «Kodi i sjelles».

Mënyra si e trajtojmë njëri-tjetrin

Respekti

Ne respektojmë çdo person pa varësisht origjinës së tij, gjinisë, bindjes fetare apo aftësive të kufizuara, moshës apo orientimit seksual.

Ne i vlerësojmë opinionet e ndryshme.

Ne kemi një politikë me «tolerancë zero» në lidhje me ngacmimet seksuale në vendin e punës.

Ne nuk tolerojmë abuzimin me pushtetin në asnjë lloj forme.

Transparenca dhe bashkëpunimi

Ne e ndajmë informacionin haptazi dhe me shpejtësi.

Ne punojmë së bashku përtej kufijve të vendndodhjes, drejtorisë apo departamentit.

Ne jemi të gatshëm për idetë e reja dhe inovacionin. Respekti, transparenca dhe bashkëpunimi, besimi, besnikëria, një kulturë e reagimeve konstruktive si edhe një lidhësi dhe kulturë pune në përputhje me objektivat, për të cilat ne kemi rënë dakord, janë gurët e themelit të punës sonë.

Besimi

Ne jemi të hapur dhe autentikë.

Ne jemi të besueshëm dhe besnikë ndaj përkushtimeve tona.

Ne krijojmë një atmosferë pune që mundëson komunikim të hapur dhe reagime kritike.

“

Jemi të hapur
dhe autentikë.

Kultura e reagimeve konstruktive

Një kulturë të reagimeve konstruktive ne e krijojmë duke shqyrtuar praktikat ekzistuese, duke kërkuar metoda të reja veprimi dhe duke reflektuar mbi sjelljen tonë.

Gabimet ne i marrim si shkas për të kërkuar mundësi për përmirësim.

Ne jemi të bindur se njerëzit mund të evoluojnë dhe të ndryshojnë qendrimet e tyre.

Ne i menaxhojmë dhe i zgjidhim konfliktet.

Ne nuk përhapim fakte të pavërteta për përfaqësueset dhe përfaqësuesit e DW, eprorët dhe punonjësit.

Besnikëria

Ne jemi besnikë ndaj vlerave dhe strategjive të DW.

Ne marrim pjesë në mënyrë aktive në formësimin e proceseve të ndryshimeve.

Ne jemi të përkushtuar ndaj ndershmërisë dhe integritetit.

Veprimet e orientuara të objektivat

Ne punojmë në mënyrë të pavarur për të arritur objektivat e DW.

Ne përdorim ide të reja për të frymëzuar dhe inkurajuar inovacionin.

Ne jemi të orientuar drejt suksesit.



Trajtimi i partnerëve dhe palëve të treta

Prona intelektuale

Ne respektojmë dhe mbrojmë pronën intelektuale të palëve të treta në përputhje me legjislacionin përkatës.

Konfliktet e interesit

Vendimet që kanë të bëjnë me punën ne i marrim në interes të DW. Ne nuk ndikohemi nga interesat dhe marrëdhëniet private.

Ne i tregojmë në mënyrë aktive konfliktet e mundshme të interesit.

Ne sigurohemi që puna që bëjmë dhe partnerët tanë të punës dhe të projekteve të mos kenë konflikte interesi.

Korrupsioni dhe dhënia e avantazheve

Ne refuzojmë çdo formë korrupsioni dhe shmangim çdo shfaqje që mund të lërë përshtypjen se jemi të korruptuar.

Ne qëndrojmë larg çdo forme favorizimi, ryshfeti apo formave të tjera të shpërblimeve personale.

Partnerë biznesi

Ne përdorim «DW Declaration of Values», kur zgjedhim partnerët tanë të biznesit.

“ Ne i marrim vendimet në punën tonë në interesin e DW.

Dhuratat dhe shpërblimet e tjera

Ne refuzojmë dhuratat, ftesat dhe skontot (gazetareske) që vënë në dyshim pavarësinë tonë dhe që mund të na bëjnë të marrim vendime jo objektive rreth çështjeve të punës.

Ne i pranojmë dhuratat, ftesat dhe shpërblimet e tjera vetëm kur bëhen në transparencë të plotë dhe në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi dhe rregulloret e brendshme.

Ne ofrojmë dhurata dhe ftesa vetëm brenda kufijve të arsyeshëm. Çështja se çfarë është e përshtatshme orientohet në radhë të parë te këndvështrimi i Gjermanisë, duke marrë në konsideratë këndvështrimin e vendit të synuar.

Prokurimi dhe tenderimi

Ne i prokurojmë produktet, shërbimet dhe prodhimet në bazë të cilësisë, ekonomisë dhe konkurrencës në përputhje me ligjet në fuqi dhe rregulloret e brend-shme. Vendimet për blerjen bazohen në cilësitë e shërbimit dhe produkteve të ofruesve që mund të verifikohen me objektivitet. Marrëveshjet që janë të dëmshme për konkurrencën nuk lejohen.

Si i trajtojmë ne informacionet

Konfidencialiteti

Ne i trajtojmë me kujdesin e duhur sekretet dhe informacionin konfidencial të punës. Kjo vlen për përmbajtjet redaksionale si edhe të gjitha informacionet e tjera që nuk janë të përshatshme ose të caktuara për shpërndarje.

Ne u ofrojmë qasje në informacione konfidenciale, edhe kur ato ekzistojnë në formë digjitale, vetëm punonjësve që kanë nevojë ta dinë.



Mbrojtja e të dhënave

Ne grumbullojmë vetëm të dhënat e nevojshme (parimi i mbledhjes me kursim të të dhënave).

Ne sigurojmë konfidencialitet të rreptë në grumbullimin, përdorimin dhe përpunimin e lejuar ligjërish të të dhënave personale, dhe kështu i mbrojmë të dhënat nga keqpërdorimi.

Kur vendosim se ku do t'i ruajmë të dhënat dhe nëse do t'i shifrojmë ato, ne e respektojmë konfidencialitetin e të dhënave.

Teknologjia e informacionit (TI) dhe siguria e informacionit

Kur punojmë me sistemet e TI-së, ne respektojmë rregullat dhe rregulloret e TI-së dhe sigurinë e informacionit për të parandaluar keqpërdorimin e këtyre sistemeve, si brenda dhe jashtë kompanisë.

Ne jemi të ndërgjegjshëm për kërcënimet ndaj sigurisë së informacionit të DW që mund të lindin nga përdorimi i pakujdesshëm i sistemeve të TI-së prandaj marrim masat përkatëse.



“ Ne i trajtojmë të dhënat me kujdesin e duhur.

Komunikimi ynë me publikun





“ Ne e qartësojmë nëse jemi duke vepruar privatisht apo si të punësuar të DW.


Ne nuk u përgjigjemi në mënyrë të pavarur pyetjeve nga gazetarë dhe kompani mediatike në lidhje me DW në tërësi, por si parim ia kalojmë ato Corporate Communications, i cili i koordinon dhe i menaxhon këto pyetje.

Në të gjitha komunikimet, ne e bëjmë të qartë nëse po veprojmë apo punojmë si individë privatë apo si punonjës të DW.

Për të shmangur konfliktet e mundshme të interesit, ne i ushtrojmë angazhimet tona shtesë jashtë DW, të cilat mund të kenë eventalisht efekt publik, brenda kuadrit të procedurës sonë të brendshme të miratimit.

Standardet tona të sigu- risë dhe të zhvillimit të qëndrueshëm

“ Ne veprojmë
në mënyrë të
përgjegjshme për
qëndrueshmëri
afatgjatë.




Ne respektojmë udhëzimet për shëndetin dhe sigurinë në punë.

Ne respektojmë rregulloret tona për shërbimet në zonat e krizave.

Ne sillemi duke respektuar zhvillimin e qëndrueshëm, në veçanti duke përdorur burimet e disponueshme në mënyrë kursimtare dhe miqësore për mjedisin dhe duke u kujdesur për mundësinë e riciklimit.

Ne kujdesemi që veprimet tona të mos kenë efekte të padëshiruarra negative te partnerët tanë (parimi i mosdëmtimit).




Trajtimi i pronës së institucionit nga ne

Ne i menaxhojmë me kujdesin e duhur mjetet e punës sonë dhe pronat e tjera të DW.

Rezultatet e punës sonë ne i vëmë në dispozicion të DW.

Ne respektojmë parimet e efikasitetit dhe të kursimit të mjeteve të punës.

“ Ne i kushtojmë vëmendje efikasitetit dhe të qenit sa më ekonomik.





Made for minds.



Parimet dhe standardet tona redaksionale

Ne jemi të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë tona ndaj publikut si ndikues në formimin e mendimit dhe veprimet me kujdesin e nevojshëm.

Ne i kryejmë detyrat tona në përputhje me ligjin e DW dhe «Kodin e sjelljes».

Ne punojmë në mënyrë të pavarur redaksionale dhe gazetareske dhe nuk ndikohemi nga interesat e palëve të treta.

Ne respektojmë mendimin ndryshe në kuptimin e pluralizmit dhe shumëllojshmërisë së pikëpamjeve dhe inkurajojmë dialogun.

Ne u përmbahemi parimeve të detyrimit për kujdes gazetaresk, kryejmë punë hulumtuese rrënjësore dhe raportojmë në mënyrë të informuar dhe të balancuar.

Ne u përmbahemi rregullave për ndarjen e përmbajtjes publicitare nga përmbajtja redaksionale.

Ne jemi të përkushtuar ndaj respektimit të privatësisë dhe trajtimit me korrektësi të informacionit, mendimeve dhe imazheve.

Ne respektojmë udhëzimet e DW për mediat sociale dhe kodin gazetaresk të kryeredaktorit.



“ Ne u përmba-
hemi parimeve
të detyrimit për
kujdes në punën
gazetareske.

**Udhëzime për
zbatimin e
«Kodit të
sjelljes»**

Masat e DW në rast shkeljesh



Në rast shkeljesh DW do të marrë masat e duhura për sqarimin dhe parandalimin me efikasitet të incidenteve të ngjashme në të ardhmen. Kjo do të thotë që fillimisht punonjësve të prekur u shpjegohet në një bisedë të përbashkët rëndësia e «Kodit të sjelljes», me synim arritjen e ndryshimit të sjelljes në përputhje me rregullat e vendosura. Në varësi nga serioziteti i shkeljeve do të përcaktohen masat e nevojshme dhe adekuate në bazë të ligjit të punës, të cilat mund të përfshijnë edhe masën e jashtëzakonshme të ndërprerjes së marrëdhënies së punës apo të shërbimit.

Nëse mund t'u përgjigjeni të gjitha këtyre pyetjeve me një «Po» të qartë, vendimi juaj duhet të jetë në përputhje me kërkesat e «Kodit të sjelljes». Por, nëse nuk jeni i sigurt, personat e mëposhtëm mund t'ju ndihmojnë.

Pyetjet e mëposhtme mund t'ju ndihmojnë të respektoni «Kodin e sjelljes»

- A po i respektoj unë rregulloret përkatëse ligjore dhe organizative?
- A po e koordinoj unë paraprakisht dhe në kohë vendimin me palët e tjera që duhet të përfshihen?
- A po e marr unë vendimin tim vetëm në interes të DW dhe në mënyrë të pavarur nga interesat e mia?
- Cili është ndikimi i jashtëm i vendimit tim?
- A do ta përballonte vendimi vlerësimin nga palë të treta? A do të ruhet reputacioni i mirë i DW?
- A mund të jem i qetë në ndërgjegje për vendimin tim?

Personat tanë të kontaktit për çdo pyetje



Nëse nuk jeni i sigurt ose keni pyetje në lidhje me respektimin e «Kodit tonë të sjelljes», ju lutemi kontaktoni stafin drejtues ose Të Ngarkuarën e Pajtueshmërisë.

Personat që mund të kontaktoni te ne në rast shkeljeje

«Kodi i sjelljes» është një rregullore e detyrueshme për të gjithë punonjësit e DWs.

Kur mendoni se po vini re një shkelje në institucionin tonë, e rëndësishme është që në fillim t'i drejtoheni direkt personit ose personave që mendoni se po sillen në kundërshtim me rregullat. Na kontaktoni, nëse keni përjetuar vetë shkelje.

Në varësi të llojit të shkeljes, mund ta raportoni gjithashtu incidentin te eprori juaj ose te E Ngarkuara e Pajtueshmërisë Annelie Gröniger: compliance@dw.com
[+49.228.429-2105](tel:+492284292105)

Sigurisht, mund të kontaktoni edhe personat e tjerë përkatës për kontakte, në veçanti për faqësuesit e stafit ose, po të jetë e nevojshme, Të Ngarkuarën e Jashtme

për Korrupsionin ose personat e kontaktit përgjegjës për mbrojtjen nga ngacmimet seksuale.

Në çdo rast, mund të jeni i sigurt se raportimi juaj do të trajtohet me konfidencialitetin maksimal.

Masat e DW në rast shkeljesh

DW do të marrë masat e duhura sqaruese në rast shkeljesh. Kjo do të thotë se punonjësve në fjalë në fillim do t'u shpjegohet rëndësia e «Kodit të sjelljes» në një diskutim të përbashkët për të arritur një ndryshim në sjellje në përputhje me rregulloret që përmban Kodi. Është e mundur gjithashtu që shkeljet të sjellin ndryshime në statusin e punësimit brenda kuadrit të rregulloreve përkatëse dhe në përputhje me ligjet në fuqi të punës.

